



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-8446/22
Kaçanik, 31.03.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e III (tretë) e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 31 mars 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimi ishin 26 anëtarë, ndërkaq pas miratimit të procesverbalit, arriti anëtar Raif Kasa, kështu që pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 27 anëtarë-të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtori i drejtive: Qamil Stagova-DUKMM, Dardana Tafili-Dauti-DAP Sali Malsiu-DSHMS, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Bahri Selimi-DBF dhe Ramadush Osmani-DSHPE, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bujar Bajra, Festim Neziraj dhe Arbnora Kuka.

Monitorimi i mbledhjes nga strukturat vendore bëhet përmes Telprezencës nga Gëzim Sahiti-zyrtarë i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoit Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtëse Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu pëershëndetë gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër. **Paraprakisht iu përkujtoj së sot është dita e fundit për Deklarim të pasurisë, ata të cilët e kanë deklaruar pasurinë në vitin 2021, ta keni parasysh se duhet me deklaru pasurinë, përndryshe mund të përballeni me pasoja ligjore.**

Kushte pune për t'u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e III-të (tretë) të rregullt të kuvendit të komunës për vitin 2022, data 31 mars, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Rregullore për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës;
3. Propozim Rregullore për ndryshim plotësimin e rregullores 01Nr. 346-18740/2013 të datës 29.07.2013- për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve;
4. Propozim Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike ‘Pastërtia’ SH.A. Njësia Kaçanik;

5. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës 2022;
6. Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e auditimit të vitiit 2021, nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
7. Raporti i punës i Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19, në komunën e Kaçanikut;
8. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), për vitin 2022;
9. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Ivajë, parcela me nr. 585-2;
10. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Kovaçec, parcela me nr. 174-0;
11. Propozim Vendim për ndryshimin e trasesë rrugore në parcelat kadastrale nr. 1579-2, 1579-3 dhe 3126-0 ZK Begracë;
12. Plani vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2022.

Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës.

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 12 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj: Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës e datës 28.02.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-4832/22.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave;

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Arta Avdiu: E kam një kërkesë për kryetarin e komunës; Disa komuna si; Prizreni, Vushtrria, Hani i Elezit, Skenderaj, Obiliqi, Ferizaj... etj. ndajnë një shumë të mjete buxhetore për çdo fëmijë që vjen në jetë, me qëllim të përkrahjes së nënave lehon. Andaj, kérkoj që kjo praktikë të ndiqet edhe në komunën tonë. Kérkoj nga kryetari i komunës që nga buxheti i komunës të rishikohet mundësia për ndarjen e mjeteve buxhetore për fëmijë të porsalindur, pasisë kjo do të jetë një mbështetje financiare për të gjithë prindërit e komunës tonë.

z. Adnan Reka: Meqë deri tani nuk mora një përgjigje me shkrim për kërkesën time, insistoj të marr një përgjigje me shkrim nga ju Kryesues, apo të na i përcillni një kopje të kërkesës që ja keni drejtuar MAPL-së në lidhje me mungesën e justifikueshme të asamblistit në seancën e KK. Do të thotë, të na dërgoni një përgjigje me shkrim, kur mund të mungojë një asamblist në një seancë te KK dhe të mos i hiqet mëditja.

Kryesuesi i Kuvendit: Neni 11 pika 2. e Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 16/2008 për kompensimin e stafit politik në komuna, anëtarët e KK të cilët nuk marrin pjesë në mbledhje të KK, iu zvogëlohet kompensimi për 125 për seancë. Nuk ka sqarim tjetër, ne i përbahemi këtij UA, ka pasur raste që iu kanë drejtuar anëtarët që kanë munguar MAPL dhe kanë marrë të njëjtën përgjigje. Kushdo që ka probleme në mungesë të seancave që iu ka hequr mëditja, t'i drejtohet MAPL dhe nëse është përgjigja pozitive, e fusim përgjigjen në procesverbal.

z. Adnan Reka: Unë nuk po kërkoj asgjë më tepër, pos përgjigjes me shkrim, në mënyrë që pastaj t'i drejtohem MAPL, me i treguar se i kemi ndjekur të gjitha rrugët, dhe t'na jasin një përgjigje, që kjo bien ndeshë me Rregulloren e punës së KK e thotë që për mungesa të justifikueshme, me na e sqaruar çka është e justifikueshme e çka është e pajustifikueshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me kërkesën, një përgjigje të dërgoj me shkrim Adnan.

znj. Kadrije lika-Troni: Shprehi shqetësim për grumbullimin e mbeturinave në Boulevardin "Ismail Raka". Nuk e di a jeni në dijeni ju, mua me ka rastisur me pa vet gjendjen, lokacioni ku janë grumbulluar mbeturinat sa e di unë është pronë private. A iu ka térheqë pronarit ndonjëherë vërejtje nga komuna me i hequr mbeturinat, nëse jo, a ka intervenuar komuna.

z. Agim Çaka: Lidhur me kërkesën të cilën e kam ngritur në një mbledhje të KK për Qarshinë e vjetër të qytetit, e kam marrë një përgjigje, në të cilën përgjigje është shënuar sa ka kushtuar projekti, sa mjete janë shpenzuar, realizimi i projektit thuhet së zgjatë 24 muaj, mirëpo nuk e kam të qartë kur ka filluar projekti, a janë duke shkuar punët sipas dinamikës, a ka ndonjë problem me pronën, a ka pasur projekti elemente të qershishë së vjetër? Është në obligim të komunës me i ruajtur gjërat e vjetra, që janë trashëgimi kulturore, së është humbje e madhe nëse ky projekt nuk ka elemente të qarshishë së vjetër, ndërkaq do të ishte mirë me u publikuar projektin diku në qytet se qysh ka me u dukur projekti.

2. Shprehi shqetësim për neglizhencë të komunës të ndërtimet pa leje. Veprimet e nevojshme merren në kohën e fushatës apo të ndonjë festë, ndërkaq pas kësaj çështja ngelë nën hije.

3. Shprehi shqetësim për hedhjen e mbeturinave në hapësira publike, të tuneli lokacioni -të Guri i shpumë. Aty është krijuar një pamje jo e mirë, e cila e prishë pamjen e autostradës, lumit lepenc etj. Mendoj se organi kompetent duhet marrë veprime të nevojshme në atë drejtim.

4. Pyetje për çështjen e ujit të pajes në qytet dhe në f. Dubravë. Uji i pajes kur ndalët, pastaj vjen me shtypje të lartë, i dëmton pajisjet e ekonomisë familjare. Në Dubravë, rezervari ekziston, por nuk ka dyer, ndërkaq rezervuari duhet me pasur edhe siguri, marrë parasysh rrëthanat politike që jemi.

z. Qamil Stagova-DUKMM: Kontrata është nënshkruar në muajin gusht të vitit të kaluar. Aty është një problem për çështjen e trafos. KEDS nuk reagon për çështjen e vendosjes së trafos së re. Projekti i Qarshisë së vjetër i qytetit ekziston, kush është i interesuar mundet me ardhër për ta parë parë.

Kryesuesi i Kuvendit: Kush është i interesuar, e merr planin të drejtoria.

z. Naim Beça: Pyetjet të cilat i kam ngritur, nuk kam marrë përgjigje. Kam pasur pyetje për një projekt në fsh. Runjevë dhe për rrugën e cila është nisur në Kaçanik dhe nuk ka përfunduar. Projektet të cilat po fillojnë në Kaçanik, nuk po përfundojnë. Kërkoj përgjigje me

shkrim se qytetarët po pyesin e jo unë. Kur përfundojnë rrugët të cilat janë nisur, rruga ‘Emin Duraku’ se nuk është në rregull ta vizitoj dikush Kaçanikun e me pa në këtë gjendje rrugën; rruga është pa ndriçim, pa kurrfarë kushte normale. Me mirë ka qenë kjo rrugë me herët sesa tani.

2. Në rrugën “Skënderbeu, të shkallët, unë kam qenë dëshmitar kur një fëmijë është rrëzuar aty, se ato shkallë nuk janë shkallë si duhet të jenë. Kemi edhe rrugë tjera të cilat janë nisur e nuk janë përfunduar, si rruga të “Saniteksi”.

z. Rrustem Zenuni: Desha me u ndërlidhur me kërkesën e Agim Çaka, për projektin e Qarshisë së vjetër të qytetit. A ka mundësi me na i dërguar drejtori të gjithëve në email projektin e mos të shkojmë në zyre me pa projektin secili anëtar i KK ?

z. Ramadush Osmani-DSHPE: Përgjigjet në pyetje dhe kërkesa të ngritura në mbledhjen e kaluar, janë dërguar me shkrim, i keni në email, shikoni emailet.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa tjera nuk ka, atëherë vazhdojmë me pikët tjera të rendit të punës:

2. Propozim Rregullore për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është prezent , nëse ka kush diçka, e hap diskutimin:

z. Agim Mani: Edhe pse deri tani komuna nuk ka pasur rregullore për mbrojtje nga zjarri, është mundësi e mirë me këtë rregullore të caktohen disa pika në të gjitha hapësirat e administratës komunale ku paraqitet rrezik dhe përhapje nga zjarri. Kërkojmë që kjo rregullore të gjënë zbatim në praktikë nga organet përgjegjëse të komunës si; Kryetari, DSHPE, stafi i komunës dhe zyrtarët tjere përgjegjës për mbrojtje nga zjarri.

z. Kadri Krivenjeva: Pasi kryesuesi për momentin nuk është prezentë, në cilësi të zëvendës kryesues, fjalën ia jap znj. Fitore Vishi.

z. Fitore Vishi: E vlerësoj të rëndësishëm këtë dokument për sigurinë e objektit të komunës, nuk jam njoħe e problematikës, por është e kuptueshme që zjarri mund të ndodhë në çdo kohë edhe gjatë orarit të punës, sfidat mund të paraqiten edhe nga klima dhe vështirësitet natyrore. Mendoj se një pjesë e stafit komunal duhet trajnohet për raste emergjente si dhe të sigurohen mjete të nevojshme teknike, mekanike dhe automatike për intervenime në raste të nevojshme. Masat për preventive për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitet natyrore në objektin e administratës, duhet të merren sikur mos ti kishim fare zjarrfikësit, sepse mund të jenë në ndonjë punë tjetër që paraqitet nevoja. Në këtë kuptim, sidomos në zyra me dokumentacione të rëndësishme si ato të arkivit dhe urbanizmit, do të ishte mirë të bëhet instalimi i rrjetit për thithje të zjarrit, sigurimi i shkallëve emergjente për zyrtarë dhe për palë të cilët mund të gjenden eventualisht në rast rreziku nga zjarri apo fatkeqësitet tjera natyrore. Nëse këto çështje janë përfshirë në rregulloren, aplikimi i masave parandaluese dhe ato të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitet tjera natyrore duhet të kenë prioritet primar në zbatimin e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Rregulloren e kësaj pike dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori vendim me të cilin e,

APROVOJ

**Rregullore për masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri në objektin e komunës/
Lënda: 01Nr. 217.01-7690/22.**

3. Propozim Rregullore për ndryshim plotësimin e rregullores 01Nr. 346-18740/2013 të datës 29.07.2013- për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është prezent në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Unë nuk po shoh asgjë tjetër në këtë draft, pos një ndryshim plotësimi të një nenit, mirëpo ky tekst nuk rregullon apo funksionalizon më mirë ndërmarrjen publike. I vetmi ndryshim është së, këtij bordi iu kanë reviduar kompetencat për caktimin e tarifave për nisjet nga stacioni i autobusëve për linjat ndër-urbane, urbane-periferike dhe linjave për kombitaksi. Këto tarifa të aprovuara nga bordi i ndërmarrjes së stacionit të autobusëve, ky bord ka funksionuar sa kohë dhe nuk ka arritur të bëjë një planifikim apo politika për të gjeneruar të hyra që kjo ndërmarrje të funksionoj nga të hyrat vetanake, kur dihet se kompania ka një pozitë të mirë për të ushtruar edhe veprimitari tjera në bashkëpunim me komunën përgjenerim edhe të hyrave tjera dhe mos të varet vetëm nga ngritja e tarifave. Ne jemi kundër kësaj rregulloreje për ngritje të tarifave në këtë kohë krize.

z. Rrustem Zenuni: Desha të sqaroj se tarifat përcaktohen nga bordi i ndërmarrjes, por bordi pa miratim të komisionit të aksionarëve nuk mundet me vendosur për tarifat. Këtu është një kontroll i mirë, rregullorja nuk iu jep kompetenca bordit me vendosur si donë ata vet. Rregulloren e miraton kuvendi, mirëpo pa miratim të komisionit të aksionarëve, bordi nuk mundet me vendosur për ngritje të tarifave.

z. Ramadush Osmani-DSHPE: Para se të hartohet draft rregullorja, jam konsultuar me zyrtarët ligjor. Arsyja pse e kemi proceduar ndryshimin e nenit 10 është harmonizimi i dy dokumenteve të cilat kanë të bëjnë me një veprimitari: statuti i ndërmarrjes dhe përgjegjësitet e bordit që ia mundëson rregullorja që i ka të përfshira tarifat, përfshinë tarifat e stacionit të autobusëve. Bordit nuk iu barten përgjegjësi shtesë, se i ka këto përgjegjësi, këtë e kam cekur në arsyetim. Bordi ka përgjegjësi të aprovoj tarifa të cilat janë kompetencë e bordit dhe t'i dërgoj te organi për miratim. Në konsultim edhe me zyrtarët ligjor, është vërejtur se rregullorja në nenin 13 është përcaktuar së nëse rregullorja ka konflikt të ndonjë dispozite ligjore, me ligjin përkatës dhe statutin e ndërmarrjes, mbizotërojnë ligji dhe statuti. Për të mos pasur liri të tepër bordi dhe ndërmarrja me aprovar tarifa njëanshëm, është menduar të jetë organi mbikëqyrës, komisioni komunal i aksionarëve i cili propozimin që e bjen kryeshefi të bordi dhe bordi të komisioni i aksionarëve, pa miratimin e komisionit të aksionarëve nuk do të miratohen çfarëdo tarife. Me këtë ndryshim të rregullores nuk ngritën e as ulën tarifat, por harmonizohen dy dokumente për lehtësim të veprimtarisë së saj.

z. Adnan Reka: Me këtë ndryshim të rregullores thuhet se nuk ngritën e as nuk ulen tarifat. A nënkupton kjo që iu lihet në kompetencë bordit për ngritjen dhe ulja e tarifave, si rrjedhojë për ngritjen dhe uljen e biletave për qytetarë? Nëse bordi ua ngritë tarifat kompanive, ata rrjedhimisht i ngritin biletat e qytetarëve.

z. Ramadush Osmani-DSHPE: Bordi me statut të ndërmarrjes e ka mundësinë e aprovimit të tarifave, por nuk i ka duart e lira, sepse përfundimisht tarifat ia aprovon komisioni i

akcionarëve- organ ky i formuar nga KK. Bordi mundet me propozu një tarifë, komisioni i aksionarëve i kërkon sqarime të nevojshme për ulje apo ngritje të tarifave, dhe nëse e vlerëson së një propozim i bordit është ndeshë me politikat në nivel komunës apo e atakon qytetari, e ka të drejtën mos me ia aprovuar tarifën e propozuar. Me ligjin e ndërmarrës publike, komisioni i aksionarëve është mbikëqyrës i bordit të ndërmarrjes.

z. Adnan Reka: Problemi është së deri tani si ka qenë çështja, kush ka marrë vendim për ngritje të tarifave?

z. Ramadush Osmani-DSHPE: Rregullorja është e aprovuar në vitin 2013. Unë po e sqaroj tani pse jemi duke shkuar në këtë formë. Kemi pasur një kërkesë nga bordi për ngritje të tarifave, adresuar drejtorit të DSHM dhe komisionit të aksionarëve. Çështja është, ose me miratu atë kërkesë që me u ndryshuar tarifat e propozuara apo që KK mos me u marrë çdo vit me ndryshime të tarifave, por kjo kompetencë i bartet një organi - komisionit të aksionarëve, të cilin me propozim e kemi bërë në konsultim me zyrtarin ligjor.

z. Agim Mani: Drejtor, a keni kërkuar ndonjëherë llogari nga bordi, kur dihet sesi funksionon dhe në çfarë gjendje është stacioni i autobusëve. Nuk ka as ndriçim, as mbishkrim. Rregullorja ka qenë e mirë, çështja është të zbatimi i saj. Bordi i ndërmarrjes e bëjnë ngritjen e çmimeve me i ngritur pagat e tyre, ndërkaq nuk kanë bërë ndonjë plan sesi me gjeneruar të hyra tjera, mundësia ka ekzistuar për gjenerim të hyrave tjera brenda stacionit të autobusëve.

z. Ramadush Osmani-DSHPE: Aktualisht, e vetmja e hyrë e rregullt me vetëfinancimin e ndërmarrjes është pagesa për hyrje në peron. Të hyra tjera gjatë sezonit të mërgimtarëve lëshohet për parking pas orës 20:00 për hapësirë në stacionin e autobusëve, pastaj të hyrat nga një reklamë e cila paguhet njëherë në vit. Kjo është botë e biznesit, bizneset kërkojnë lokacion ku gjenerojnë të hyra me tepër. Ata e kanë hapësirën për me vendosur kioska, por çështja është së a kanë kërkesa për vendosje të kioskave.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Rregulloren dhe e njëjtë u aprovua me 14 votë Për, Kundër ishin 7 anëtarë nga LVV, Abstenuan: 6 anëtarë (4 anëtarët nga LDK, anëtarët nga LVV Raif Kasa dhe anëtarët nga NISMA Agim Çaka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Rregulloren për Ndryshim Plotësimin e Rregullores 01Nr. 346-18740/2013 të datës 29.07.2013- për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga stacioni i autobusëve / Lënda : 01Nr. 346/01-7660/22.

4. Propozim Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike ‘Pastërtia’ SH.A. Njësia Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, e hapi diskutimin për këtë pikë:

z. Adnan Reka: Ky Propozim Vendim është vërtet tepër i pa arsyeshëm dhe i pa skrupullit. Shtrohet pyetja, Pse t’ia marrim OVL-së parkingjet publike e t’ia japim ‘Pastërtisë’? Ndërmarrja publike ‘Pastërtia’ i ka asetet e veta, ju vetëm duhet t’ia ktheni menaxhimin e mbeturinave në vendbanimet, Kaçaniku i Vjetër, Begracë dhe Koxhaj, sepse kjo ndërmarrje publike është e specializuar për këtë gjë. Një gjë e tillë madje është edhe kundër ligjore,

shërbimet publike të komunës nuk mund t'i jepen dikujt përmes shpalljes publike, ato duhet të jepen përmes procedurave të prokurimit publik. Ju në njëren anë ja hiqni tregun më të përshtatshëm ‘Pastërtisë’ vendbanimet më të mëdha dhe më të lehta për t'u menaxhuar të komunës, në anën tjetër ja leni terrenet më të largëta dhe me të vështira kësaj ndërmarrje publike. Pra, ndërmarrjes publike ja merrni asetet më të vlefshme dhe ja jepni kompanisë private, a ka më absurd? Po pra, sepse ju e mbroni interesin privat para interesit publik. Kjo a e di si i bie? lufta u krye, hajde ta ndajmë plaçkën! apo, zgjedhjet i fituam bashkë edhe haraçin duhet ta ndajmë bashkë.

z. Naim Beça: Parashtrohet pyetja, pse me ia dhënë në menaxhim “Pastërtisë” parkingjet? Pse me ia dhënë dikujt 0.30 cent për parkingje, kur dihet se parkingjet i kemi ndërtuar ne me vet kontribute, populli i ka ndërtuar dhe populli po duhet me i paguar përsëri?

z. Ramadush Osmani-DSHPE: Ne si komunë, si DSHPE, jemi për mbrojtje të ambientit. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2019-2021, mbi 95 % të objektivave janë mbuluar me shërbim të mbeturinave. Ne si drejtori jemi në kontakt të vazhdueshëm me kapacitetet dhe kushtet teknike të kompanisë “Pastërtia” dhe me gjendjen në teren. Ne po flasim për një vendim që ligjërisht është i drejtë. Pse po i mirët një e drejtë një organi me ia kaluar një organi tjetër? Këtu kemi të bëjmë me 2 ndërmarrje të ndryshme, njëra është shoqatë e tjetra është shoqëri aksionare. Arsyja që i epët ndërmarrjes “Pastërtia, është se komuna i ka aksionet e saja, dhe ligji i prokurimit publik neni 9 pika 4 e thotë qartë: një autoritet kontraktues publik – që është komuna, para se ta jep në tender një veprimtari duhet të ketë shumë kujdese që për aktivitete, a ka operatorë publik të shtëpisë. Kur ka operatorë publik të shtëpisë, i lejohet me zgjidhur atë të shtëpisë (in hause), brenda kompetencës. NK “Pastërtia” e ka këtë aktivitet për mirëmbajtjen e hapësirave dhe parkingjeve publike. Përfitimet e komunës; ne e kemi publikuar një shpallje publike për 1 vit, SHIL ka ofertuar dhe e ka marrë për 1 vit, komuna ka inkasuar 1700€ prej këtyre parkingjeve dhe të njëjtën kohë ne kemi lidhur marrëveshje për mirëmbajtjen e asaj hapësire e cila ka kushtuar 1600 €. A duhet të paguhen parkingjet, po kjo është e rregulluar, investimi komunal duhet të kthehet në koston e saj. Si komunë kemi planifikuar me marrjen në menaxhim nga pastërtia, kjo i ka kapacitetet me menaxhuar, ne kemi mundësi brenda shtëpisë me lidhë marrëveshje për mirëmbajtje të hapësirave. Si drejtori mu mundësohet se e kam 1 punëtor teknik që çdo ditë bënë zbrazjen e kontejnerëve, që të përcaktohet me detyrë të përhershme si mirëmbajtjes të varrezave, që nuk e kemi një punëtor të tillë se nuk na kanë lejuar mjetet buxhetore, Përmes këtij vendimi, qartësohen në të ardhmen veprimet e nevojshme për mbrojtjen e ambientit. Të aspektit mbulueshmerisë, ne kemi aksione si komunë, dhe kemi obligim përmes rrugëve ligjore ta ruajmë të mos falimenton kjo ndërmarrje. Kohëve të fundit kemi bërë decentralizimin e kësaj ndërmarrje nga komuna e Ferizajt, tanë kompania menaxhon me financat e veta. Kjo është një e hyrë shtesë e kompanisë që do të mirëmbajë parkingun.

z. Naim Beça: Për çështjen e mirëmbajtjes së parkingjeve, nuk mund të flasim, sepse nuk ka mirëmbajtje. Në kohën e dimrit disa i parkojnë veturat aty e i lënë nga 2 ditë. Tarifat ua marrin për parking, por mirëmbajtje nuk ka.

Kryesuesi i Kuvendit: Komuna ka të drejtë të themeloj ndërmarrje komunale dhe t'ia jap “Pastërtisë” në menaxhim ndërmarrjen. Qëllimi është të ngarkohet kompania edhe për mirëmbajtjen e hapësirave publike. Ne si komunitet ka kohë që kemi kontraktuar me kompani për mbledhjen e mbeturinave dhe jemi të kënaqur me shërbimin, tregu është i lirë, shërbimet i ka të mira. A ka të drejtë me operuar apo jo kompania, mua nuk me intereson së

kompania e ka marrë një leje diku. Kompania "Pastërtia" deri me tani nuk ka pasur pajisje të mjaftueshme, tani shërbimet janë në përmirësim të vazhdueshëm. Të çështja e parkingut, drejtoria ka menduar për më mirë. Nëse nuk ka shërbime të mira ia marrim, ishte ofenduese çështja ndarjes së plaçkës që u tha, ajo nuk qëndron dhe unë nuk pajtohem me atë çështje që e diskuton, dhe këtë ta dokumenton secilin qytetarë i Doganaj që e pyet. Të hyrat nga parkingu, a hyjnë në nivel regional të Ferizajt, nëse është ashtu, unë jam kundër, por është thënë së kompania "Pastërtia" menaxhon vet me të hyrat e inkasuar, unë jam për këtë formë, sepse po i krijohet çështja e mirëmbajtjes së hapësirave publike nga kompania. Kam pasur kërkeshë që në kuadër të kësaj të futet edhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, me është dhënë shpjegimi nga drejtori, që punëtorët të cilët i kemi në mirëmbajtje të bulevardit, njeri nga ta të caktohet në mirëmbaje të varrezat e dëshmorëve.

z. Adnan Reka: Ju duhet me qenë me institucionalist se ne këtu. Ju po thoni që qytetarët marrin vendime, atëherë çfarë është arsyja me marrë ne vendime, kur qytetarët vendosin. Institucioni nuk vepron në këtë formë, komuna ka rend ka rregulla, e jo të vendosë qytetari si të donë vet, do çështje i vendos së ti imponon ligj, e jo për shkakun tuaj të individit, së në këtë rast po doni me thënë se jemi pak përtej ligjit. Kompania që menaxhon mbeturinat në Doganaj, është e njëjtë që i ka menaxhuar edhe në Begracë, Kaçanik të Vjetër, kompania "Krasniqi", d.m.th. edhe kur nuk keni pasur pavarësi financiare nga Ferizaj, i ka menaxhuar kjo kompani, se ju ia keni dhënë atë aset dhe ju ja jepni sa herë atë aset operatorit ekonomik për me i fituar zgjedhjet, dhe lidhet kontrata nëse i fitoni zgjedhjet, përndryshe ia bëni me dije së mbetet pa punë. Në këtë rast po e dëmtoni kompaninë publike. Pse ato lokalitete nuk shkon menaxhimi i tyre përmes prokurimit publik? Sepse mund t'i merr dikush tjetër, së është aset jashtëzakonisht i rëndësishëm, ku gjenerohen të hyra.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne nuk punojmë me atë logjikën e juaj. Me gjeni ju një ligj i cili e ndalon atë operator, nëse ne kemi bërë shkelje si qytetarë, atëherë ia ndërprenë kontratën operatorit. Kompania nuk ka kontratë me komunën, por ka kontratë me secilin qytetarë. Kompanisë ia ka dhënë të drejtën me operuar se ka të drejtë me ia dhënë, se ia mundëson ligji. Është tregu i lirë, sikur të operatorët e komunikimit, ne nuk po lidhim të gjithë kontratë me postën, por me operatorë të ndryshëm, veç atë logjikën tënde që nesër me ardhur në pushtet mbetemi pa punë, nuk brengosëm fare, sikurse nuk jeni brengosur as ju që 20 vjet.

z. Naim Beça: Shprehi shqetësime për çështjen e menaxhimit të mbeturinave nga kompania "Pastërtia" në qytet, ndërkaq shtoj, se kisha dashur që shtëpia ime të ishte në lokacione ku mblidhen mbeturinat. Sa ka me qenë çmimi i një parkingu, sepse çmimi është shumë i lartë. Kërkoi me vendosë një çmim më simbolik, se është tarifë e lartë për ata të cilët vijnë nga terreni për shërbime shëndetësore dhe duhet të paguajnë parkingun, se për juve nuk është i shtrenjtë 0.30 cent, dhe po iu garantoj se asnje funksionar i komunës nuk i ka dhënë 0.30 cent, as që kanë guxim me iu ofruar buletë juve, ne jetojmë në Kaçanik dhe e dimë këtë punë.

z. Agim Çaka: Me ia marrë menaxhimin e parkingjeve SHIL të UÇK e me ua dhënë kompanisë' Pastërtia, unë nuk e kam sa duhet të qartë këtë çështje. Nëse është ndonjë interes i madh me u ngritur niveli i pastërtisë në qytet, atëherë është tjetër. Ne e dimë se SHIL e ka marrë tarifën, ndërkaq nuk e ka pasur obligim me mirëmbajtur ambientin. Nëse kjo kishte me pasur efekt, se edhe Naimi e tha që në kohën e dimrit disa i parkojnë veturat aty e i lënë nga 2 ditë, nëse ky vendim merret që me i koordinuar dikush ato punë, atëherë në rregull. Edhe këtu po shkruan që është një lloj testi, nëse nuk funksionon, ne jemi këtu përsëri. Nëse mendohet që ka diçka prapa kësaj, ne jemi këtu si opozitë me kritikuar. Është mirë një

komunikim pak me i kulturuar në mes anëtarëve të KK, se jemi të gjithë këtu për një qëllim për interesa të qytetarëve. Pagesa është njëjtë si me ia dhënë shoqatës si pastërtisë, por interes i joni duhet me qenë niveli i pastërtisë. Cilado vendim që merret për çështjen e nivelit të pastërtisë, është në rregull, ndërkaq nëse del se dikush ka pasur interes në këtë punë, ne mund të mblidhemi përsëri me diskutuar këtë çështje dhe me ia potencuar direkt atij që ka pasur interes. Shumica vendosë, ne që nuk pajtohem pastaj mundemi me kritikuar e me i dhënë vërejtjet tona, jo vetëm për këtë çështje, por për çdo vendim tjetër që diskutohet në KK. Unë jam i thirrur për diskutime konstruktive dhe në interes të qytetarëve.

z. Betim Shala: Desha me u ndërlidhur me diskutimin e kryesuesit në çështjen ku e potencoju menaxhimin e mbeturinave në f. Doganaj. Me ngritur paralele, atëherë edhe ne po dashka në zona - vende ku jetojmë, kompania e cila menaxhon me mbeturina në lokalitetin e juaj, me menaxhuar mbeturinat edhe në lagjet tona. Nëse e shikojmë këtë çështje në një kënd tjetër, atëherë ndoshta jemi të detyruar një pjesë e popullatës me pas menaxhimin e mbeturinave nga kompania "Pastërtia", e me partcipuar për mirëmbajtje të parkingjeve me faturime për mirëmbajtje të ambientit, ndërsa një pjesë tjetër me pasur të drejtë me vendosur një kompani më të mirë për menaxhimin e mbeturinave. A kemi të drejtë atëherë edhe ne me u organizuar për me na i menaxhuar mbeturinat një kompani tjetër ?

Kryesuesi i Kuvendit: Ju keni qenë zyrtar komunal, dhe ju jeni ai i cili duhet treguar qytetarëve se cila është e ligjshme, cila jo. Nëse me kuptove, unë fola si qytetar, e jo si zyrtar komunal. Unë nuk e di a është e ligjshme apo jo, por dikush i ka dhënë leje kompanisë me funksionuar, besoj se nuk është e kundërligjshme. Nëse është e kundërligjshme operimi i atij operatori, ju mundeni me ngritur si çështje këtë punë.

z. Betim Shala: Unë nuk e kam problemin me operatorin në Doganaj, problemin e kam me operatorin këtu në Kaçanik, se nuk e kryen punën si duhet.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Këtu është vendi për me debatuar dhe me i ngritur shqetësimet. Nuk do me thënë se ne ia qëllojmë çdo herë, se edhe ne mund të gabojmë. Kur debati është konstruktiv për tema të caktuara, besoj se edhe ia arrijmë. Ne jemi duke menduar për të bërë me të mirën e mundshme, se për interesat të qytetarëve jemi këtu për të diskutuar. Në kohën kur iu ka dhënë SHIL, ka qenë mirë që iu ka dhënë, se nuk kanë pasur asnjë burim të financimit, ndërsa sot ata marrin një kompensim solid. Tani është bërë decentralizimi financier dhe jemi detyruar me marrë një vendim, ndërkaq për ligjshmëri është dikush tjetër që na mbikëqyrë, dhe mënyra me e mirë dhe me e lehtë është më ia dhënë kompanisë "Pastërtia". U tha se po e privilegjojmë një kompani karshi kompanive tjera, nuk është e vërtetë, kompanitë licencohen nga dikush tjetër e jo nga kryetari. Kompania e cila menaxhon mbeturinat në fshatrat të cilat u përmenden, është mbi 10 vite, pasi që kompania kommunale nuk ka mundur me përfshi atë pjesë. Ju po thoni se nuk po ia merr këto fshatra e më i dhënë kësaj kompanie, nuk po mundem, se kemi fshatra që ende nuk janë përfshirë ne menaxhim. Në momentin kur kompania do të ketë kapacitete të mjaftueshme, se po shpresojmë se ka me i ngritur kapacitet, edhe nga granti në gara për ambient të pastër edhe nga premtimin për 2 makineri, në momentin kur përshihen komunitetet që nuk janë në menaxhim, atëherë është me e arsyeshme kompania kommunale me menaxhuar me mbeturinat. Tarifat janë përcaktuar në bazë të rregullores të aprovuar në KK, duke menduar se është e arsyeshme se duhet mirëmbahen parkingjet, dhe kjo po i epët kompanisë, me qëllim të mirëmbajtjes, të pllakat, të varrezat e dëshmorëve. Se si do të funksionoj kjo, do të shohim brenda 1 viti. Nëse nuk

funkcionon mirë, atëherë ia marrim të drejtën e menaxhimit të parkingjeve. Çështja ka qenë me i rritur shërbimet dhe cilësinë në punë.

z. Naim Beça: Tarifën me zbrite 20 cent, është shumë më mirë, se dihet gjendja në komunën tonë, sepse ka njerëz të komunës tonë nuk kanë mjete për barna, e lërë më me paguar parkingje. A po premtoni që nëse nuk e mirëmbajnë parkingjet, ia heqim të drejtën për mirëmbajtje brenda afatit të caktuar? Unë kam me përcjellë gjendjen e mirëmbajtjes së parkingjeve për një vit, me foto etj.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Nëse ka iniciativë prej grupeve parlamentare me ndryshuar, unë nuk e kam problem, por gjendja nuk është ashtu siç thoni, për shkak se në çdo kohë nuk ka parkingje të lira. Nëse i kategorizojmë njerëzit, me qenë rast social, rastet sociale nuk duhet me pasur as veturë.

z. Adnan Reka: Unë nuk e di se a kemi përgjegjësi më të madhe ndaj kompanisë publike apo asaj private. Nëse keni obligim me u kujdesur, atëherë obligim kemi më të madh ndaj kompanisë publike, sepse është aksionare. Terrenet me të mira janë Kaçaniku i Vjetër, Begraca, Koxhaj etj., ndërsa Lanishtë, Ivajë etj. janë terrene më të vështira. Nëse doni që me gjeneruar të hyra kompania publike, atëherë nuk mundesh me ia marrë terrenet me të mira e me ia dhënë një kompanie private, e me u ankuar pastaj se kompania publike nuk po mundet me gjeneruar të hyra. Terrenin me të mirë duhet me ia dhenë kompanisë që është me prioritet, e jo me lënë me falimentuar kompaninë publike. Nëse doni me fuqizuar kompaninë publike, atëherë ia jepni menaxhimin e mbeturinat të krejt lokaliteteve.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Nuk ia kam dhënë unë në menaxhim kompanisë private ato lokalitete, por i ka në menaxhim që 10 vjet. Unë po dua që të mbulohen të gjitha lokalitetet me menaxhim, se për momentin kompania publike nuk ka kapacitete të mjaftueshme.

z. Kadri Krivenjeva: Me shumicën e kërkesave të cilat ngritën nga anëtarët e KK, edhe unë pajtohem, sepse ne jemi këtu për të punuar sa më mirë për interesa të qytetarëve. Çka nuk po mundem me u pajtuar unë është: në njëren anë kërkohet nga komuna menaxhim sa më të mirë të mbeturinave, ndërkaq në anën tjetër kritikohemi, për menaxhim të mbeturinave të një kompanie me kapacitetet që i ka. Ku është ajo e mirë që kompania me i pasur kapacitetet e mjaftueshme për menaxhimin e mbeturinave me mbuluar tërë territorin e komunës, por çështja është se edhe ne qytetarët duhet me qenë të vetëdijshëm, me të kulturuar e mos me hedhur mbeturina vend e pa vend, se ne jemi ata të cilët duhet ruajtur ambientin dhe pronën kommunale. Vetëm në këtë mënyrë ne mundemi me përmirësuar gjendjen aktuale të mbeturinave.

z. Agim Mani: Qëllimi ynë është që të ndihmohet kompania publike me veprimtarinë primare që e ka. Të bëhet shtrirja e menaxhimit të mbeturinave e kompanisë "Pastërtia", sepse nuk jam shumë i saktë, por 30 % nuk e mbulon kjo kompani me mbeturina. Shtrirja bëhet duke u mbikëqyrur nga organet kompetente. Vetëm l herë me dal në terren inspektori, i sheh deponitë ilegale. Ka lagje që nuk janë të përfshira fare në menaxhim të mbeturinave. Shqetësimi ynë është që, kompania mos po joshet me taksat nga parkingjet të cilat taksa mblidhen fare lehtë, ndërkaq e lënë anash punën e vet primare, dhe menaxhohen keq mbeturinat.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin dhe e njëjtë u aprovua me 19 votë Për, Kundër ishin 7 anëtarë nga LVV, Abstenoj 1 - anëtarë nga LVV Raif Kasa. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për dhënien në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike ‘Pastërtia’ SH.A. Njësia Kaçanik / Lënda: 01Nr. 104/02-7676/22.

Pas kësaj pike, Kuvendi i Komunës bëri një pauzë në bazë të kërkesës së tyre, ndërkaj pas pauzës, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj me vazhduar mbledhja me pikët e radhës, duke filluar nga pika e pestë;

5. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin;

z. Agim Mani: Të ky Propozim Vendim, me vet fakti që po barten mjete vetanake në shumën 706,271.35€, lënë të kuptohet se këto mjetet nuk kanë arritur të shpenzohen në bazë të vizionit apo planifikimit të paraparë, edhe pse kemi pasur buxhetin e vogël dhe kërkesat e vazdueshme të qytetarëve. Nga të HVK të vitit 2021, kanë qenë 969.906€, të shpenzuara, 221.217€, të pashpenzuara dhe të pa rialokuara 343.274, d.m.th i bien që të HVK 2021 janë shpenzuar vetëm 400.4000€ apo 41%, ndërkaj 58% nuk janë shpenzuar. Mjete të pashpenzuara ka edhe nga viti 2020 të cilat janë bartur në vitin 2021, shuma 141.000 €. Në total barten mjete 706.271.35€. Me këtë buxhet të vogël, kjo shumë e madhe e mjeteve të pashpenzuara nuk jep garanci se do të shpenzohen, sepse nëse i shkojmë vitet paraprake 2019, 2020, 2021, vlera e mjeteve të pashpenzuara shkon duke u rritur.

z. Rrustem Zenuni: Me i shikuar mjetet e mbetur nga vitet paraprake 706,271.35€ janë shumë, por duhet cekur së në njërin anë kjo ka ardhur si rrjedhojë e ngritjes së të HVK, në vitin 2021, e që më ngritje janë inkasuar të HVK 1million euro. Mjetet që barten nga 2020 dhe 2021, shihet se pjesa me e madhe e tyre shkojnë në investime kapitale, dhe është mirë që i kemi këtu mjete dhe po shkojnë në vendin e duhur.

z. Agim Mani: Shuma e mjeteve të ngelura nga viti 2020, 141.000€ janë bartur në vitin 2021 dhe nuk janë shpenzuar. Cila është arsyja ?

z. Bahri Selimi-DBF: Atë që e tha z. Zenuni, është e vërtetë, 10.000 € kanë shkuar në subvencione dhe transfere, mjetet tjera iu kanë kthyer qytetarëve në mënyrë indirekte, pagesat e tatimit në pronë dhe taksa tjera në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në përgjithësi. Shih. Tabelat, nga mjetet e bartura, 706.271.35€, 696.271€ janë për investime kapitale. Po t'i kishim orientuar për mallra dhe shërbime këto mjete, ka pasur vend për kritikë. Argumenti i 2-të i Zenunit është inkasimi i të HVK mbi planifikim. Kjo është e vërtetë, sepse për pak nuk kemi arritur me inkasuar 1million euro në vitin 2021. Kjo është përforma më e mirë prej se ekziston komuna. Të HVK nuk kthehen diku tjetër, por i mbisin komunës. Këto të hyra nuk iu del afati, mundem me i shpenzuar në çdo kohë sepse këto mjete nuk humbin.

z. Agim Mani: Qëllimi është së këto mjete janë të parapara për 1 vit, me u shpenzuar në atë vit. Munden me u bartur vit pas viti mjetet, por çështja është me i shpenzuar, se shumë mjetet janë të parealizuara, ndërkaq në anën tjetër barten mjete.

z. Bahri Selimi-DBF: Kemi pasur shumë mjete nga GQ, nga raporti finansiar shihet se nuk kemi kthyer mjete, kjo është me rëndësi. Po t 'kishim bartur mjete në njëren anë dhe grantin me kthyer suficit, ajo është përformancë e dobët. GQ i mbetur është vetëm 0.56%.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin e kësaj pike dhe i njëjtë u aprovua me 19 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 8 anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës 2022 / Lënda: 01Nr. 400/01-7824/22.

6. Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e auditimit të vitit 2021, nga Zyra Kombëtare e Auditimit;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori i DBF e ka sjellë një njoftim për raportin periodik të zbatimit të rekomandimeve. Nëse ka kush diçka, lë të urdhëroj; Meqë nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj së Kuvendi i Komunës, u,

Njoftua

Me Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e auditimit të vitit 2021, nga Zyra Kombëtare e Auditimit / Lënda: 01Nr. 470/03-7566/22.

7. Raporti i punës i Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19, në komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Shtabi komunal e ka sjellë Raportin e punës për parandalimin e Covid-19, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj;

z. Agim Mani: Meqë jam anëtar i Shtabit komunal, kur funksionon KKSB edhe Shtabi komunal e ka përbërjen pothuajse të njëjtë, rekomandimet që dalin nga Shtabi dhe KKSB pothuajse janë të njëjta.

Kryesuesi i Kuvendit: Të interesuar tjerë me marrë fjalën nuk ka, atëherë konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Raportin e punës i Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19, në komunën e Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 104/02-7822/22.

8. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dimë, si KK e kemi miratuar formimin e KKSB. Ky këshill e ka sjellë një plan pune të cilin e miraton KK, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kur thuhet se Plani vjetor i punës së KKSB është orientues dhe jo domosdoshmërisht nuk do të kufizohet vetëm në këto pika të caktuara. Ky këshill do të trajtoj edhe tema tjera varësisht nga kërkjesat dhe zhvillimet gjatë këtij viti. Ky plan është i pakontestueshëm, mirëpo paraprakisht ka qenë dashur me u kompletuar përbërja e KKSB me

I anëtar të FSK. Ne, kur është formuar ky këshill kemi abstenuar, për shkak se nuk i keni sjell emrat. Ne cilin Udhëzim apo Rregullore shkruan që nënkyetari i komunës mundet me qenë pjesë KKSBB ?

Kryesuesi i Kuvendit: Unë nuk jam kompetent në këtë se nuk e di, anëtarët e di se përfaqësohen sipas detyrave që kanë. Anëtarin e FSK besoj se nuk e kanë sjellë ende ata të FSK, për atë dhe ka ngelur pa u plotësuar. Të zëvendësimi i kryetarit, besoj se është në bazë të kompetencave që ia jep LVL në mungesë të kryetarit, e zëvendëson nënkyetari, se është e natyrshme që gjatë një viti kryetari mund të mos marrë pjesë në ndonjë mbledhje për arsyet e ndryshme.

Kryetari i Komunës: Pjetje shumë naive, sepse rregullorja që e përcakton këtë çështje është që 10 vjet.

z. Agim Mani: Pyetja nuk ishte naive, por po kërkoj sqarim, formimi i KKSBB ishte diçka tjetër. Ne për atë nuk e kemi votua formimin e KKSBB se nuk i keni sjellë emrat me kohë.

z. Adnan Reka: Agimi është përfaqësues i popullit dhe mund të ngrit pyetje nga më të ndryshme. Kryetari mund të konsideroj naive pyetjen, përgjigja e kryetarit ishte në njëfarë forme vulgare, se në fund të fundit Agimi e sqaroj se në bazë të një UA është i specifikuar përbërja e KKSBB me emra të përcaktuar dhe ishte legitime pyetja qysh e ngriti.

Kryetari i Komunës: Gjithkund ku nuk është kryetari, zëvendësohet me nënkyetarin e komunës.

z. Agim Çaka: Për pyetjet të cilat i ngritëm është mirë me marrë një përgjigje normale. Është e ditur së çdo herë nëse mungon kryetari, e zëvendëson me automatizëm nënkyetari. Sqarimin u desh me bërë nga nënkyetari, për atë arsyet figuron në listë, vetëm është dashur me u cekur që në mungesë të kryetarit, zëvendësohet nga nënkyetari.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Planin e punës së KKSBB e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 19 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 8 anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori,

VENDIM

Me të cilin e Aprovoj Planin e punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), për vitin 2022/ Lënda: 01Nr. 60/01-7922/22.

9. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Ivajë, parcela me nr. 585-2;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është prezent në mbledhje për sqarime, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Livoreka: Desha të bëjë një sqarim të shkurtër në këtë pikë; janë 2 parcela të cilat janë dhënë për zgjerimin e rrugës, sepse rruga ka qenë shumë e ngushtë. Nuk besoj se ka pasur ndonjë interes tjetër aty, këto parcela janë marrë për zgjerimin e rrugës.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin e kësaj pike dhe i njëjtë u aprovua me 19 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 6 anëtarë nga LVV (Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Erneseta

Krasniqi, Arta Avdiu, Bashkim Luma). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori,

VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Ivajë, parcela me nr. 585-2/ Lënda: 01 Nr. 06-941/01-4538/22.

10. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Kovaçec, parcela me nr. 174-0;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe këtu kemi të bëjmë me një këmbim të pronës private me atë komunale, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Veprimi i juaj për ndërtimin e shkollës në pronë private nuk është në rregull. Nëse keni pasur marrëveshje paraprake është dashur me treguar, kur dihet fakti se kjo shkollë është ndërtuar me buxhetin e komunës. Kjo procedurë që po kryhet sot, ka pasur mundësi me u kryer para 6-7 viteve në një mbledhë të rregullt apo të jashtëzakonshme të KK.

z. Selajdin Troni: Sa i përket parcelës që kërkohet me u këmbyer prona, është e një familje e cila e ka dhënë pronën, e cila familje po të ishte kërkuar edhe e kishte dhënë edhe pa kompensim. Janë dhënë 273m², ndërkaq janë marrë 314m² dhe kjo sipërfaqe ka shërbyer në të mirë të shkollës, ndërkaq asnjë interes nuk ka pasur në këtë drejtim.

z. Adnan Reka: Ne nuk jemi kundër shkollës, por kundër mënyrave që janë ndjekur, pasi që para se të ndërtohet një rrugë apo objekt, fillimisht duhet bëhen studimet e fizibilitetit, të merret pëlqimi, d.m.th të merren të gjitha veprimet paraprake para se të ndërtohet rruga apo shkolla. Si rregull në parim kemi abstenuar dhe përsëri do të abstenojmë.

z. Betim Shala: Ne LDK-a jemi për miratimin e këtij Propozim Vendimi, ndërkaq pasi të kryhen procedurat e këmbimit, të kryhet procedura e bartjes së pronës në kadastër.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin e kësaj pike dhe i njëjtë u aprovua me 19 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 6 anëtarë nga LVV (Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Erneseta Krasniqi, Arta Avdiu, Bashkim Luma). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori,

VENDIM

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Kovaçec, parcela me nr. 174-0 / Lënda: 01Nr. 06-941/01-8081/22.

11. Propozim Vendim për ndryshimin e trasesë rrugore në parcelat kadastrale nr. 1579-2, 1579-3 dhe 3126-0 ZK Begracë;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kur është dhënë në shfrytëzim kjo pronë, ne i kemi shprehur shqetësimet tona dhe kemi abstenuar. Ende pa filluar kompania punën ka hasë në vështirësi. Me çfarë të drejtë një pronë e cila ipët në shfrytëzim një pronari, intervenohet në atë pronë ?

z. Besnik Salihu: Kryesues, nëse ka mundësi drejtori me na dhënë sqarime më të hollësishme. Unë në mandatin e kaluar kam votuar me ia dhënë në shfrytëzim komplet pronën kompanisë shfrytëzuese. Nëse ka pasur ndërhyrje, kisha pasur dëshirë më pas sqarime të nevojshme drejtori.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori do të jap sqarime, por fillimi shkak i interesuar me marrë fjalën.

z. Qamil Stagova-DUKMM: Firmës JLG Construction SHPK, me pronar Agron Zeneli, iu është dhënë në shfrytëzim nga KK për një periudhë 40 vjeçare 2 parcela në Begracë, të cilat prona i ndan një rrugë për qasje në pronë të komunitetit, për operim me të mirë dhe për objekte ndërtimore, është bërë ndryshimi i kësaj rruge e cila rrugë mbyllt, ndërkaq hapet rruga e re kah skaji i parcelës. Nuk ka pasur ndonjë ankesë nga qytetarët e f. Begracë. Në momentin kur iu është dhënë në shfrytëzim, është ditur se kjo gjë ka me ndodhur.

Kryesuesi i Kuvendit: Dy parcela të cilat i janë dhënë në shfrytëzim kompanisë në fjalë, i ka ndarë ajo rrugë përmes. Tani ai ka kërkuar me u bërë bashkimi i 2 parcelave për shkak të investimit që është duke e bërë, ndërkaq rruga ka me u ç ‘vendosur më në skaj që është edhe shumë më mirë.

Kryetari i Komunës: Kompania e ka rrethuar pronës e mos me qarkulluar njerëzit përmes objekteve, do të mbyllt ajo rrugë, ndërkaq rruga ka me u hapur më në skaj.

z. Besnik Salihu: Unë në kam qenë anëtar i komisionit për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone, kam pas propozuar që investitorëve me ia hapur edhe rrugën, se shtetet tjera ia ndërtojnë edhe objektin pa pare, pasi që nuk paska probleme, unë jam për miratimin e ndryshimit të trasesë rrugore në atë lokacion.

z. Agim Çaka: Është krejt normale dhe duhet me llogaritur që kur i epërt dikujt prona për interes privat dhe në interes të komunës, duhet me ia ofruar edhe kushtet për me pasur sukses kompania. Kërkoj një pyetje nga shërbimi teknik: A kemi mundësi me pasur 1 apo 2 monitor për me pasur qasje në këto problematika në çështje të tillë e të ngashme, se nuk po i kemi sa duhet të kuptueshme vetëm përmes skicave. Përmes monitorit na sqarohet se ku kanë me qenë ndryshimet, ne i shohim me drejtpërdrejtë dhe e vlerësojmë se a bënë më u bërë këto ndryshime apo jo.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa e Agimit është e arsyeshme, salla nuk i plotëson kushtet, por sidoqoftë unë do të bëjë përpjekje. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin e kësaj pike dhe u aprovua me 20 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 7 anëtarët nga LVV (Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ermeseta Krasniqi, Arta Avdiu, Bashkim Luma dhe Naim Beça). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndryshimin e trasesë rrugore në parcelat kadastrale nr. 1579-2, 1579-3 dhe 3126-0 ZK Begracë, e cila pronë i është dhënë në shfrytëzim kompanisë JLG Construction SHPK, me pronar Agron Zeneli / Lënda: 01Nr. 06-941-7338/2022.

12. Plani vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: A është plotësuar ky komitet, kur e dimë që anëtarët: Artan Mezraja dhe Arxhenta Axhami kanë dhënë dorëheqje ?

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk është plotësuar, ne kemi kërkuar nga MAPL me u plotësuar ky komitet me kandidatët të cilët kanë qenë në listë, mirëpo nuk na kanë lejuar, kështu që tani duhet shikuar me u plotësu këtë komitet. Përbërja e këtij komiteti ka qenë prej 7 anëtarëve, dorëheqje kanë ofruar 3, ndërkaq tani është në përbërje prej 4 anëtarëve, d.m.th ka kuorum për funksionuar.

z. Adnan Reka: Këtu përbërja shënon së është me 6 anëtar. A keni mundësi me na njofuar kur është zgjedhur ky komitet.

Kryesuesi i Kuvendit: Në vitin 2019 është zgjedhur ky komitet në përbërje prej 7 anëtarëve, se nuk ka komisione me 6 anëtarë 1 anëtar ka dhënë dorëheqje me herët, Albana Fuga. Sektori i KK do të dërgoj vendimin për formimin e këtij komiteti. Kryesorja është që kur u vendosë kjo çështje keni qenë pjesë e KK. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2022/ Lënda: 01Nr. 60/01-8268/22.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që Kryesuesi i Kuvendit Kemal Murseli e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 13:16. Deri në fund të mbledhjes ishin të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik


REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK
(Legjislatura 7 e Kuvendit të Komunës, të dalë nga Zgjedhjet Lokale të 17 Tetorit 2021)

Evidencia e pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga mbledhja e III-të (tretë) e rregullt, mbajtur me 31 Mars 2022

1	2	3	4	5
Nr. Rend.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Përkatësia politike	Nënshkrimi
01.	Brahim Imishti	Anëtar	PDK	
02.	Hamide Luma	"	PDK	
03.	Kadri Krivenjeva	"	PDK	
04.	Fitore Vishi	"	PDK	
05.	Rrustem Zenuni	"	PDK	
06.	Edon Baftiu	"	PDK	
07.	Selajdin Troni	"	PDK	
08.	Fatmir Bunjaku	"	PDK	
09.	Bashkim Krasniqi	"	PDK	
10.	Florina Lika-Vishi	"	PDK	
11.	Lejla Muhaxheri-Çaka	"	PDK	
12.	Agim Mani	"	LVV	
13.	Kadrije Lika-Troni	"	LVV	
14.	Adnan Reka	"	LVV	
15.	Naim Beça	"	LVV	
16.	Raif Kasa	"	LVV	
17.	Ernesta Krasniqi	"	LVV	
18.	Bashkim Luma	"	LVV	
19.	Arta Avdiu	"	LVV	
20.	Ardita Rahmani	"	LDK	
21.	Besnik Salihu	"	LDK	
22.	Betim Shala	"	LDK	
23.	Arlinda Rakoci-Raka	"	LDK	
24.	Rabije Sallahi	"	AAK	
25.	Ekrem Livoreka	"	AAK	
26.	Agim Çaka	"	NISMA	

Vërtetoj: Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Murseli



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

**Nga Mbledhja e III-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2022,
mbajtur me 31 Mars 2022:**

1. Kemal Murseli,
2. Brahim Imishti.....,.....,
3. Hamide Luma,
4. Kadri Krivenjeva,
5. Fitore Vishi,.....,.....,
6. Rrustem Zenuni,.....,.....,
7. Edon Baftiu,.....,
8. Selajdin Troni,
9. Fatmir Bunjaku,
10. Bashkim Krasniqi,
11. Florina Lika-Vishi,
12. Lejla Muhamheri-Çaka.....,.....,
13. Agim Mani,
14. Kadrije Lika-Troni,
15. Adnan Reka,
16. Naim Beça,.
17. Raif Kasa,
18. Ernesta Krasniqi,.....,.....,
19. Bashkim Luma,
20. Arta Avdiu,
21. Ardita Rrahmani,
22. Besnik Salihu,
23. Betim Shala,.....,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,
25. Rabije Sallahi.....,.....,
26. Ekrem Livoreka.....,.....,
27. Agim Çaka.....,.....,